FEDERATA E GJIMNASTIKËS
E
KOSOVËS

STATUT

FGJK – KGF Shtëpia e Sporteve/House of Sport, Rr/ Str. "Agim Ramadani" 10000, Prishtinë,
E-Mail: kosovagymnasticsfederation@gmail.com tel:+38344145009

Në përputhje me nenin **20** të Ligjit **Nr. 06/L-043** për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, Nenin **19** dhe nenin **20** të Ligjit **Nr. 08/L-277**, për Sport në harmoni me Statutin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Federatës Botërore të Gjimnastikës (FIG), Kuvendi i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 09/03/2025 miraton këtë:

STATUT - FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

NENI 1

EMRI, FORMA LIGJORE, PËRBËRJA, SELIA

1. Emri i zyrtar i Federatës është ''Federata e Gjimnastikës e Kosovës'', dhe krahas emërtimit të plotë organizata do të funksionon edhe me akronim ''FGJK'', ndërsa në komunikimet ndërkombëtare do të përdoret edhe emërtimi në gjuhën Angleze ''Kosova Gymnastics Federation'' me akronim ''KGF''.

2. FGJK-ja përfaqëson bashkimin vullnetar të Shoqatave dhe Klubeve sportive të FGJK-së në Republikën e Kosovës, gjimnast/e, trajnerët, gjyqtarët, veprimtarët, drejtuesit e gjimnastikës si dhe dashamirët e këtij sporti në Kosovë nëpërmjet klubeve.

3. Përgjegjësia e FGJK-së, rregullohet sipas Ligjit Nr. 04/L-30, për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale si dhe Ligjin Nr. 04/L-077 për marrëdhëniet dhe detyrimet.

4. FGJK-ja duke u njohur si e tillë nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e Republikës së Kosovës, (MKRS), Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK), Federata Internacionale e Gjimnastikës (FIG), Gjimnastika Europiane (EG), Gjimnastika Mesdhetare (COMEGYM), Gjimnastika Ballkanike (BG), e ka autoritetin e vetëm në territorin e Kosovës për të gjitha çështjet në lidhje me sportin e Gjimnastikës.

5. FGJK është themeluar më datën 12.12.2012 në ora 12.00 në Prishtinë, dhe është e regjistruar në Minsitrinë përkatëse për Administratë Publike, Departamenti për OJQ në Prishtinë – Kosovë si një OJQ sportive jo-fitimprurëse, me datë 20/06/2013, sipas Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.

6. Selia e Federatës e Gjimnastikës e Kosovës është në Prishtinë, Rruga ''Agim Ramadani'', Nr. 253, objekti i Shtëpisë së Sporteve, kati 3, Nr. 20.

NENI 2

FLAMURI, VULA DHE LOGO

1. FGJK, ka Llogon dhe Flamurin e vet të aprovuar nga Kuvendi i FGJK-së.

2. FGJK ka vulet e saja zyrtare sipas legjislacionit të aplikueshëm dhe të aprovuar nga Kuvendi i FGJK-së.

3. Llogoja e FGJK-së është me një figur gjimnasti në ekuilibër dhe e kombinuar me simbole të Flamurit Shtetëror si dhe në pjesën e epërme permban mbishkrimin në gjuhën shqipe FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS edhe mbishkrimin në gjuhen angleze KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION, dhe gjithashtu akronimet FGJK dhe KGF.

4. Flamuri i FGJK-së ka formën me simbolet e njëjta si në Logo (materiali i mendafshtë).

5. FGJK ka Vulën e saj në formë të rrethit dhe katrore në gjuhën zyrtare (shqip dhe anglisht). Vula në formë rrethi ka të shkruar tekstin sipër si në vijim: ''FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS'', dhe teksit i njejtë është i shkruar në gjuhën angleze poshtë '' KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION''. Në mes të vulës është llogoja e Federatës.

6. Llogoja, flamuri dhe vulat përdoren në punët zyrtare të FGJK-së dhe në komunikimin vendor dhe ndërkombëtar.

NENI 3

PARIMET

1. **Sporti për të gjithë** – përfshinë unitetin e përgjithshëm të veprimit, respektimin e ndërsjellë të anëtarëve dhe papranueshmërinë e diskriminimit ndaj anëtarëve ose individëve në bazë racore, politike, fetare, gjinore ose në baza tjera.;
2. **Ligjshmëria** - veprimet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij statuti, dhe Ligjin përkatës për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Tjera Negative në Ngjarjet Sportive, Ligjin përkatës për Sport, Ligjin përkatës për Sponsorizimin në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe legjislacionin përkatës sekondar që derivojnë nga këto ligje, dhe në harmonizim me statutin dhe rregulloret e FIG.
3. **Qeverisja e mirë** – FGJK respekton parimet e përgjithshme dhe themelore të Qeverisjes së Mirë, Kodin e Etikës të FIG; Kodin e Lëvizjes Olimpike për Parandalimin e Manipulimit të Garave, Kodin Mjekësor të Lëvizjes Olimpike, Rregullat Anti-Doping Kombëtarë dhe të FIG, Manualin e Komitetit Ndërkombëtar Paraolimpik.
4. **Mosdiskriminimi dhe Ambienti i sigurt** – FGJK angazhohet të sigurojë një ambient pune dhe sportiv në të cilin të gjithë individët trajtohen me respekt, dinjitet dhe pa ngacmim. Çdo individ ka të drejtë të marrë pjesë dhe të punojë në një mjedis

i cili promovon mundësi të barabarta dhe ndalon praktikat diskriminuese, çdo shkelje e të drejtave të njeriut nuk është e lejuar pa marrë parasysh gjininë, ngjyrën, gjuhën, fenë, mendimin politik apo opionion e tij, prejardhjën sociale apo etnike, orientimin seksual, lidhjen me bashksinë etnike pronën apo lindjen si dhe mbron qëllimin, realizimin e të drejtave, detyrave, obligimeve dhe programeve mbi bashkimin e të interesuarve të përcaktuar me këtë Statut.

5. **Transparenca** - veprimet e FGJK-së janë transparente dhe dokumentet publike duhet të jenë të qasshme në përputhje me ligjin përkatës për qasjen në dokumente publike.

6. **Mbrojtja e privatësisë**–veprimet nuk cenojnë privatësinë dhe të dhënat personale të personave të përfshirë në aktivitet sportiv mbrohen në përputhje me ligjin përkatës.

7. **Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjëve**– ndërmarrja e të gjitha masave mbrojtëse për fëmijët dhe të rinjtë pjesëmarrës në sport, në të cilat përfshihen njoftimi i policisë, organit të kujdestarisë dhe organeve të tjera shtetërore përkatëse për çdolloj dhune ndaj tyre, keqpërdorim, ngacmim ose sjellje tjetër të pahijshme.

8. **Mbrojtja e mjedisit dhe siguria publike** - FGJK angazhohet të marrë një qasje të përgjegjshme për mbrojtjen e mjedisit dhe administrimin e burimeve përmes praktikave të saja në organizimin e ngjarjeve dhe në administrimin e aktiviteteve të saja.

9. **Fair-play** – sporti zhvillohet në bazë të rregullave, konkurencës së ndershme, respektit ndaj kundërshtarit, parandalimit dhe shmangies së dhunës dhe sjelljes jo të drejtë.

NENI 4

QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E FEDERATËS

1. FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS është organizatë jofitimprurëse. Të ardhurat që krijohen në FGJK nga burimet të ndryshme ligjore riinvestohen për zhvillimin e aktivitetit të FGJK-së.

2. Federata e Gjimnstikës e Kosovës ka këto objektiva dhe detyra:

2.1. Të zhvillojë, promovojë, kontrollojë dhe rregullojë aktivitetin sportiv të shoqatave dhe klubeve që janë nën ombrellen e FGJK-së, në të gjitha format e tij, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në përputhje me këtë statut në disiplinat e mëposhtme:

1. Gjimnastikën Artistike, Meshkuj dhe Femra,
2. Gjimnastikën Ritmike,
3. Gjimnastikën në Trampolinë,
4. Gjimnastikën Akrobatike,
5. Gjimnastikën Aerobike ,
6. Gjimnastikën për të gjithë.

2.2. Vepron kundër përdorimit të dopingut, në përputhje me vendimet e KOK-ut, FIG dhe WADA (World Anti-Doping Agency) dhe zbaton vendimet e tyre.

2.3. Duke kryer edhe punë tjera të përcaktuar me Ligjin për Sport, benefitet e Ligjit për Sponsorizimin e Sportit dhe aktet tjera normative.
2.4. Të ndihmojë në mënyrë të kualifikuar në rritjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve, miqësore midis anëtareve të federatës si dhe të mbrojë të drejtat e anëtareve të saj dhe kujdeset për zgjidhjen e problemeve tekniko-organizative, sportive duke u mbështetur në Statut, Rregullore të saj, legjislacionin në Kosovë si dhe aktet ligjore ndërkombëtare të veprimtarisë së sportit përkatës.
2.5. Të nxisë konkurrencën miqësore sportive dhe eliminimin e praktikave të padrejta dhe jopërkrahëse si kurdisja e garave, korrupsioni në gara, bastet e paligjshme, doping ose pajisje të paligjshme.
2.6. Promovimi, organizimi dhe mbikqyrja e garave dhe aktiviteteve të FGJK-së.
2.7. Masovizimi i pjesëmarrjes në të gjitha nivelet, rritja e popullaritetit të FGJK-së, kërkimi dhe sigurimi i burimeve të reja i të ardhurave dhe menaxhimi i FGJK-së në përputhje me planin strategjik të FGJK-së.
2.8. Inkurajimi i gjimnastëve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe zyrtarëve që të paraqesin FGJK-në pozitivisht në mënyrat më të mira për të përmirësuar imazhin e FGJK-së.
2.9. mbështetja e punës profesionale dhe aftësimi i personelit të FGJK-së.
2.10. Mbështetja për kushtet e përgatitjeve të gjimnastëve elitar për Lojrat Olimpike, Kampionate Botërore, Europiane, Mesdhetare, Ballkanike dhe garat tjera ndërkombëtare.
3. Zbatimi i qëllimeve dhe veprimtarive të FGJK-së-së bëhen përmes aktiviteteve në përputhje me planin strategjik të zhvillimit dhe programet zhvillimore të aprovuara nga Bordi Ekzekutiv dhe Kuvendi dhe aktiviteteve në vijim:
3.1. duke organizuar paraqitjen e Përfaqësuesëve të FGJK-së,
3.2. duke organizuar gara në Kosovë, veçmas Kampionatet, Kupat vendore dhe garat sportive ndërkombëtare ku marrin pjesë Përfaqësueset tona,
3.3. duke rritur numrin e gjimnastëve /eve dhe të klubeve,
3.4 duke organizuar seminare për trajnerë, gjyqtarë dhe kurse për aftësimin e administratorëve,
3.5. duke botuar revista profesionale elektronike e duke përdorur rrjetet elektronike sociale, që zhvillojnë një mënyrë më të përsosur të propagandës dhe marketingut për Gjimnastikësn Kosovare;
3.6 duke marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga KOK-ut, dhe asociacioneve tjera sportive.
3.7 duke ndarë shpërblime dhe mirënjohje nga FGJK,
3.8 duke dërguar shpresat tona dhe garuesit e rinjë dhe më përspektivë në qendrat e njohura ndërkombëtare në përgatitje dhe trajnime speciale,
3.9 duke organizuar kampe stërvitore vendore me eskpertë të njohur botërorë nëpërmjet FIG, EG, KOK dhe Solidaritetit Olimpik,
3.10 duke intensifikuar bashkëpunimin me Federatat e tjera nga rajoni me qëllim të shkëmbimit të përvojave në organizim dhe profesionalizëm,
3.11 duke përparuar punën e Komisionit të trajnerëve dhe gjyqtarëve;

3.12. Duke vepruar kundër përdorimit të dopingut, në përputhje me vendimet e KOK-ut, FIG dhe WADA (World Anti-Doping Agency) dhe zbaton vendimet e tyre,
3.13. duke kryer edhe punë tjera të përcaktuara me Ligjin për Sport, benefitet e Ligjit per Sponsorizimin e Sportit dhe aktet tjera normative.

NENI 5

BAZA E VIZIONIT, MISIONIT DHE PLANIT STRATEGJIK

1. Baza e vizionit të FGJK-së është Gjimnastika, për të gjithë, gjatë gjithë jetës dhe gjimnastikë elitare.
2. Baza e misionit të FGJK-së është promovimi në mënyrë aktive i Gjimnastikës në Kosovë, duke krijuar piramidë të zhvillimit e cila është e vazhdueshme, progresive e strukturuar dhe garuesë për gjimnastët/tet, trajnerët, gjyqtarët, administratorët dhe zyrtarët e garave, nga niveli fillestar deri në Lojra Olimpike.
3. Qeverisja profesionale dhe zhvillimore e FGJK-së, bazohet në planin strategjik 4 vjeçar të FGJK-së, në përputhje më ciklin olimpik, i cili udhëhiqet nga promovimi i vlerave si: Pasioni, Rivaliteti, Integriteti, Respekti, Disiplina, Krenaria, Profesionalizmi, Komunikimi dhe Transparenca.

KREU II

NENI 6

ANËTARËSIA

1. Anëtarë të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës mund të jenë: Klubet e Gjimnastikës, (publike dhe private), Shoqatat e trajnerëve, gjyqtarëve, e gjimnastëve dhe të gjitha shoqatat tjera, të cilat në baza vjetore regjistrohen me sukses sipas kritereve të përcaktuara ne Rregulloren përkatëse të FGJK-së, për regjistrimin e klubeve dhe anëtarëve, do të pranohen në Federatë pas miratimit nga Kuvendi.
2. Klubet apo organizatat e Gjimnastikës janë anëtarë të FGJK-së në territorin ku e ushtrojnë veprimtarinë sportive.
3. Anëtarësia në FGJK është e hapur për çdo klub gjimnastikorë që vepron në territorin e Republikës së Kosoves dhe që është e regjistruar në Minsitrinë e Administratës Publike, Departamenti për OJQ në Prishtinë, Kosovë si OJQ sportive dhe posedon çertifikatën zyrtare të lëshuar nga ky institucion,
3.1. Si shoqëri tregëtare e regjistruar në ARBK në ministrinë përkatëse sipas nenit 21 pika 2 të ligjit të sportit Nr. 08/L-277.
4. Rregullat e punës, konstituimi dhe funksionimit të anëtarëve duhet të jenë në harmoni me dispozitat e këtij statuti, rregulloreve të FGJK-së, Ligjit të Sportit, Ligjit për OJQ, dhe ligjit për shoqëritë tregtare si dhe të njejtit janë përgjegjës për zbatimin e vendimeve të organeve të FGJK-së.

NENI 7

E DREJTA E FITIMIT TË ANËTARËSISË

1. Aplikimi i anëtarëve për regjistrim bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Rregulloren përkatëse të FGJK-së për regjistrim të klubeve dhe transferimin e gjimnastëve.
2. Bordi Ekzekutiv e federatës rishikon raportin e komisionit për regjistrim për të gjitha aplikimet për anëtarsi dhe i rekomandon për pranimin në Kuvendin e rregullt të punës para fillimit të sezonit garues kalendarik.
3. Për anëtarët ekzistues aktiv, Bordi Ekzekutiv sipas raportit të komisionit për regjistrim e bënë konfirmimin e anëtarësisë. Ndërsa për anëtarët e rinj dhe anëtarët të cilët nuk e kanë paraqitur kërkesën për ripërtirjen e regjistrimit, Bordi Ekzekutiv sipas raportit të komisionit për regjistrim i paraqet rekomandimet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.
4. Kuvendi me shumicën e votave të anëtarëve prezent 50% + 1 me të drejtë vote merr vendim për rekomandimet e Bordit Ekzekutiv për regjistrime.

NENI 8

TË DREJTAT E ANËTARËVE

1. Klubet apo organizatat e Gjimnastikës, të cilat janë të themeluara dhe të regjistruar në organet perkatëse komunale, të cilat posedojnë me infrastrukturë të nevojshme, kuadër profesional, dhe se posedojnë vertetimin me shkrim për regjistrim si klub apo organizatë sipas rregullores mbi regjistrimin e FGJK-së dhe Statutit të FGJK-së.
2. Si forma të organizimit dhe ndikimit në Federatë mund të themelohen Shoqatat e gjyqtarëve dhe trajnerëve të Gjimnastikës sportive, të cilat realizojnë të drejtat, detyrat dhe interesat e tyre të përbashkëta konform dispozitave të këtij Statuti, dispozitave tjera të FGJK-së dhe FIG, dhe akteve të tyre normative.
3. Trajnerët dhe punëtorët tjerë profesional i realizojnë të drejtat dhe obligimet e tyre drejtë për së drejti në klubet apo organizatat e Gjimnastikës - klubet e tyre qoftë të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, qoftë në baza amatore.
4. Të pajiset me kartën e anëtarësimit,
5. Të pajiset me statutin dhe rregulloret e FGJK,
6. Të përfaqësohet me të drejtë vote në Kuvend (asamble e përgjithshme),
7. Të informohet me vendimet e Bordit Ekzekutiv të FGJK-së,
8. Të pajiset me botimet e ndryshme që bën Federata,
9. Të marr pjesë në aktivitetet zyrtare e miqësore, kombëtare e ndërkombëtare që organizon FGJK,
10. Të njihet më parë me programin e mbledhjes së Kuvendit dhe dokumentacionin përkatës.

NENI 9

DETYRIMET E ANËTARËVE

1. Anëtarët kanë këto detyrime:
1.1. Të respektojë Statutin dhe aktet normative të FGJK-së,
1.2. Të jetë korrekt ndaj FGJK, që nënkupton që çdo anëtar të mos ndërmarr veprime kundër interesave dhe imazhit të FGJK.
1.3. Të njoftojë menjëherë FGJK-në për çdo ndryshim në kryesi të klubit, shoqatës.
1.4. Të kërkojnë nga të gjithë anëtarët e tyre të klubit që të respëktojnë Statutin dhe aktet normative të FGJK-së.
1.5. Të jenë përgjegjës për klubin, sportistët dhe zyrtarët tjerë, duke përfshirë kryerjen e pagesave të anëtarësisë, gjobat dhe pranueshmërinë, në përputhje më Statutin dhe aktet normative të FGJK-së.
1.6 Të mbajnë kuvendet e rregullta vjetore në klubet e tyre ndërsa kuvendet zgjedhore t'i mbajnë në vitin e njejtë kalendarik kur FGJK-ja organizon Kuvendin zgjedhor dhe obligohen të njoftojnë Bordin Ekzekutiv për vendin dhe kohën e mbajtjes.
1.7. Të përmbush çdo herë kriteret për anëtarësim.
1.8. Të ketë mbështetjen dhe kujdesin mjekësor nga Federata për sportistët.
1.9. Trajnerët për të punuar në klubet e Gjimnastikës duhet t'a kenë kualifikimin përkatës të lëshuar nga organi kompetent i FGJK-së, FIG, ose diplomë universitare të edukimit fizik,
6. Lëshuarja dhe marrja e lejës - licencës për ushtrimin e veprimtarisë së trajnerit rregullohet me aktet normative mbi punën profesionale të FGJK-së dhe FIG EG etj
7. Çdo anëtar i Federatës duhet ta paguaj anëtarësinë vjetore, të cilën e cakton Bordi Ekzekutiv i FGJK-së.

NENI 10

PEZULLIMI

1. Një anëtar që dëshiron të ndërprejë anëtarësinë nga FGJK do të njoftojë me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të FGJK. Ndërprerja mund të hyjë në fuqi në çdo kohë nga marrja e një njoftimi të tillë deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit, por anëtari është i obliguar për kthimin e borxheve eventuale apo aseteve në përdorim më së largu 30 ditë nga momenti kur i është ndëprerë anëtarësimi në FGJK. Kërkesa me shkrim për ndërprerje duhet të paraqesë arsyetimin, kohën e propozuar si dhe të gjitha përpjekjet që kanë bërë për ruajtjen e anëtarësisë.
2. Një anëtari të cilit për ndonjë arsyetim të pranuar nga Kuvendi i është dhënë afate për shtyrjen e pagesës së anëtarësisë dhe i cili nuk ka kthyer pagesat apo borxhet e mbetura ndaj FGJK-së sipas afatit të caktuar nga Kuvendi do të pezullohet automatikisht nga e drejta e votës dhe pjesëmarrjes në gara të FGJK-së. Para hyrjes në fuqi të pezullimit, anëtari duhet të njoftohet me shkrim nga Sekretari i FGJK-së

për skadim të afatit dhe obligimet e papaguara, duke i dhënë edhe një afat shtesë prej 7 deri në 15 ditë për përmbushjen e tyre. Në rast se edhe pas këtij afati shtesë obligimet nuk përmbushen, pezullimi hyn në fuqi automatikisht nga dita e skadimit të këtij afati.
3. Një Anëtar i cili shkel Statutin, aktet normative dhe vendimet e FGJK-së, ndaj tij do të inicohet rasti në komisionin disiplinor sipas akteve normative të FGJK-së.
4. Anëtarësimi formal në FGJK ndërpritet si në vijim:
4.1. me fshirjen nga regjistri i Anëtarëve aktual;
4.2. nëse vërtetohet se Anëtari ka pushuar së vepruari;
4.3. nëse nuk ka mbajtur Kuvendin së paku një herë në vit;
4.4. me vendimin e Kuvendit të FGJK-së, me se paku 2/3 e votave të anëtareve te përgjithshëm të Kuvendit, ndërsa vendimmarrja mund të behet me 2/3 e anëtareve prezent në mbledhjen e Kuvendit.
4.5. me kërkesën personale me arsyetimin me shkrim.
5. Shkelja serioze e Statutit të FGJK-së, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FGJK-së i jep të drejtë Kuvendit të pezulloj çdo anëtar të saj nga anëtarësimi në FGJK për një periudhë deri në një vendim tjetër, dhe ndaj tij do të inicohet rasti në komisionin disiplinor sipas akteve normative të FGJK-së
6. Në raste urgjente Bordi Ekzekutiv mund të japë pezullim provizor (të përkohshëm) të një anëtari ose klubi, nëse ka shkelje të rëndë statutore, ose me çështje të licensimit të federatës, etj, deri në mbledhjen e radhës së Kuvendit e cila do të shprehet me një vendim, për vendimin e Bordit Ekzekutv.
7. Çdo vendim pezullimi përbën humbjen e të drejtave që lidhen me satutin e anëtarit për sa kohë që vendimi mbetet në fuqi.
8. Vendimin për përjashtim nga anëtarësia e bie Kuvendi, efektet e përjashtimit veprojnë nga dita e marrjes së Vendimit.

NENI 11

HUMBJA E STATUSIT TË ANËTARIT

Statusi i anëtarit mbaron me dorëheqjen ose përjashtimin e anëtarit.
Humbja e statusit të anëtarit, nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të pa përmbushura kundrejt FGJK ose anëtarëve të tjerë. Pezullimi e përjashton atë nga të gjitha të drejtat që lidhen me FGJK, veçanërisht nga ato që lidhen me kapitalin e regjistruar në FGJK.

NENI 12

DORËHEQJA E ANËTARIT

Një anëtar mund të paraqes me shkrim kërkesën e tij për dorëheqje me kusht që ajo të bëhet e vlefshme vetëm në fund të vitit financiar. Kërkesa duhet të paraqitet 30 ditë më parë.

KREU III

ORGANIZIMI

NENI 13

ORGANET E FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS SË KOSOVËS

Organet e federatës janë:
- Kuvendi
- Kryetari,
- Bordi Ekzekutiv,
- Sekretari i përgjithshëm,
- Këshilli Mbikqyrës,
- Komisioni Disiplinor,
- Komisioni i Ankesave,
- Komisioni për përfaqësimin e sportisteve.

NENI 14

KUVENDI

1. Kuvendi është organi më i lartë i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës. Vetëm një Kuvend i mbajtur në përputhje me rregullat e këtij statuti, ka autoritetin të marr vendime.
2. Kuvendi përbëhet nga të gjithë anëtarët e saj të cilët e kanë të drejtën të përfaqesohen me nga tre (3) delegat me të drejtë vote.
3. Në Kuvend marrin pjesë anëtarët e Bordit Ekzekutiv, pasi janë të zgjedhur dhe kanë bazë deleguese nga klubet ose shoqatat, ndërsa pa të drejtë vote anëtarët e nderit të miratuar nga Kuvendi, dhe mysafir të ftuar.
4. Mysafirët nuk kanë të drejtë vote dhe mund të diskutojnë vetëm me leje të drejtuesit të Kuvendit.
5. Shpenzimet e pjesëmarrjes në mbledhje të Kuvendit i bartë vet anëtari i Kuvendit.

NENI 15

KOMPETENCAT E KUVENDIT

1. Kuvendi i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës ka këto kompetenca:
1.1. Miratimin e Statutit, Rregulloreve dhe Vendimeve të FGJK në përputhje me ligjin për sportin si dhe me udhezimet nga MKRS, KOK, FIG, etj.

1.2. Miraton Planin Strategjik dhe propozimet e programit të përgjithshëm të sportit të FGJK-së,
1.3. Zgjedhë Kryetarin e FGJK-së, në një Kuvend të mbajtur zgjedhor në vitin e njëjtë kalendarik pas përfundimit të Lojrave Olimpike Verore. Kryetari i zgjedhur do të shërbejë për një mandat (4) vjeçar dhe do të ketë të drejtë për rizgjedhje edhe për mandate të njepasnjëshme në të njejtin funksion.
1.4. Zgjedh nëntë (9) anëtarë të Bordit Ekzekutiv të FGJK-së. Të gjithë anëtarët e zgjedhur do të shërbejnë për një mandat (4) vjeçar dhe do të kenë të drejtën për rizgjedhje edhe për mandate tjera të njëpasnjëshme në të njejtin funksion.
1.5. Zgjedh tre (3) anëtarë të Këshillit Mbikqyrës, një mandat katër (4) vjeçar,
1.6. Miraton llogaritë vjetore të FGJK-së.
1.7. Miraton raportin e punës së Bordit Ekzekutiv të FGJK-së.
1.8. Aprovon planin financiar të federatës.
1.9. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin, dhe anëtarët tjerë të Bordit Ekzekutiv të FGJK-së.
1.10. Vendosë në lidhje me mjetet e jashtëzakonshme juridike.
1.11. Vendosë mbi faljen e dënimeve.
1.12. Miraton propozimet e anëtarëve për dhënie të titujve të nderit brenda juridiksionit të FGJK.
1.13. Deklaron shkrirjen e federatës dhe likuidimin e veprimeve të saj financiare.
1.14. Miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së.
1.15. Kryen edhe punë tjera në përputhje me Statutin dhe aktet tjera të federatës.
2. Kuvendi i FGJK-së, ka të drejtën e miratimit dhe ndryshimit të Rregulloreve aktuale dhe Rregulloreve të reja të FGJK-së**:**

1. Rregulloren e Punës së Kuvendit të Federatës Gjimnastikës së Kosovës,
2. Rregullore e Këshillit Mbikqyrës të FGJK-së,
3. Rregulloren e Bordit Ekzekutiv të FGJK-së

NENI 16

EMËRIMI I DELEGATËVE

Anëtarët e Kuvendit të FGJK janë të detyruar të mbledhin Kuvendin e shoqatës, klubit, për të zgjedhur tre përfaqësuesit e tyre me të drejtë vote në Kuvendin e FGJK. Në mesin e tre përfaqësuesve duhet të respektohet barazia gjinore dhe etnike.
1. Anëtarët (shoqatat, klubet) dërgojnë pranë FGJK personat zyrtarë të autorizuar për përfaqësimin e tyre.
2. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin zyrtar (autorizim, prokurë) të shoqatës klubit sportiv etj, që vërteton se ai/ajo është përfaqësues me të drejtë vote.
3. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin e identifikimit.
4. E drejta e votës nuk mund t'i delegohet një anëtari tjetër.
5. Anëtarët (klubet, shoqatat) janë të detyruar që të sjellin emrat e personave të

autorizuar për tu përfaqësuar me të drejtë vote në Kuvend, pranë Sekretariatit të FGJK jo më vonë se 7 ditë përpara datës së zhvillimit të Kuvendit.

NENI 17

NUMRI DHE PËRCAKTIMI I DELEGATËVE

1. Numri i delegatëve përcaktohet si më poshtë:
1.1. Çdo shoqatë apo klub sportiv ka 3 (tre) delegat.
1.2. Të është shtetas i Republikës së Kosovës,
1.3. Të i ketë mbushur 18 (tetëmbëdhjetë) vjet dhe është i aftë për punë,
1.4. Është anëtarë i organizatës që përfaqëson,
1.5. Është veprimtar ose sportist dhe nuk është i gjykuar dhe nuk ka rënë në kundërshtim normat etike dhe parimet e Lëvizjes Olimpike.
1.6. Çdo delegat ka të drejtën e 1 (një) vote,

NENI 18

KUVENDI I ZAKONSHËM

1. Kuvendi i zakonshëm thirret nga Bordi Ekzekutiv jo më pak se një herë në vit. Njoftimi për Kuvend duhet t'u dërgohet anëtarëve 10 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
2. Rendi i ditës vendoset nga Bordi Ekzekutiv, rendi i ditës, raportet e aktiviteteve, buxheti, llogaritë dhe çdo dokument tjetër duhet t'i dërgohet anëtareve 7 ditë përpara datës së mbledhjes.
3. Çdo anëtar ka të drejtën të propozojë përfshirjen në rendin e ditës të një çështje. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në sekretariatin e FGJK, 5 ditë përpara mbledhjes.

NENI 19

RENDI I DITËS PËR KUVENDIN E ZAKONSHËM

1. Rendi i ditës për Kuvend të zakonshëm duhet të përfshijë të paktën çështjet e mëposhtme:

a. Verifikimi i përbërjes së mbledhjes.
b. Pranimi ose largimi i anetareve
c. Raporti i Kryetarit.
d. Miratimi i raportit të aktiviteteve të Bordit Ekzekutiv.
e. Miratimi i raportit financiar.
f. Miratimi i veprimtarive financiare për vitin pasardhës.
g. Zgjedhjet për çdo 4 vite apo për ndonjë vend të lirë (vend bosh).
h. Shqyrtimi i propozimeve për amendamentet (ndryshimet) në statut - FGJK.
i. Diskutime nga anëtarët për çështje të tjera.

2. Rendi i ditës mund të modifikohet nga një shumicë që përbën 50% +1 tw votave të shumicës.

NENI 20

KUVENDI I JASHTËZAKONSHËM

1. Bordi Ekzekutiv mund të thërrasë një Kuvend të jashtëzakonshëm, pune apo edhe zgjedhor nëse mendohet se kjo është e domosdoshme.
2. Kur të paktën 50% + 1 e delegatëve të Kuvendit të FGJK bëjnë kërkesë me shkrim, Bordi Ekzekutiv është e detyruar të thërrasë një Kuvend të Jashtëzakonshëm jo më vonë se 1 muaj pas marrjes së kërkesës.
3. Njoftimi për mbledhjen e Kuvendit të Jashtëzakonshme duhet t'u dërgohet anëtarëve 10 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
4. Rendi i ditës si dhe çdo dokument tjetër duhet tu dërgohen anëtarëve 7 ditë përpara datës së mbledhjes.
5. Bordi Ekzekutiv vendos për rendin e ditës.
6. Rendi i ditës nuk mund të ndryshohet nga çfarëdolloj kushtesh.
7. Federata e Gjimnastikës e Kosovës mund të organizojë mbledhjet e Kuvendit në formë hibride ose online, kur rrethanat e jashtëzakonshme apo nevojat e veçanta të organizimit e kërkojnë një gjë të tillë. Pjesëmarrësit në këto mbledhje do të konsiderohen të pranishëm dhe me të drejtë vote në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Rregullorja e Punës së Kuvendit, me kusht që të përdoren mjete teknologjike që sigurojnë identifikimin dhe pjesëmarrjen e plotë të anëtarëve dhe votim të sigurt dhe transparencë. Çdo vendim i kësaj natyre duhet të miratohet nga Bordi i FGJK-së dhe të raportohet në Kuvendin e ardhshëm të rregullt për miratim.
8. Me synim ruajtjen e plotë të integritetit procedural mbi çështjet me ndjeshmëri më të lartë, pikat në vijim nuk mund të vendosen në mbledhjet e Kuvendit të mabajtur në formë online:
8.2. Zgjedhjet e Kryetari dhe Anëtarit të Bordit të FGJK-së,
8.3. Pranimi ose përjashtimi i Anëtarëve të Federatës.

NENI 21

VENDIMMARRJA

1. Kuvendi, me 2/3 e votës së anëtarëve prezent, merr vendime për:
1.1 Ndryshime statutore, - pushimin e punës së Federatës, - përjashtimin e Anëtarëve apo për klasifikimin e Anëtarëve si Joaktiv, – shkarkimin e Kryetarit dhe Bordit Ekzekutiv.
2. Anëtarët e Kuvendit nuk duhet të marrin vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rendin e ditës.
3. Vendimet duhet të merren me votim të hapur me përjashtim të rastit kur 1/3 e delegatëve kërkojnë votim të fshehtë. Në rast të votave të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese kur votimi është i hapur.
4. Vendimet a marra nga Kuvendi hyjnë në fuqi menjëherë pasi ato janë miratuar, me

përjashtim të rasteve kur Kuvendi vendos për një datë të mëvonshme, ose ia delegon këtë të drejtë Bordit Ekzekutiv.
5. Anëtarët ushtrojnë të drejtën a votimit të tyre përmes delegateve të tyre zyrtarë.
5.1. Një delegat nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anëtar.
6. Mbledhje e Kuvendit të FGJK-së mbahet atëherë kur sigurohet kuorumi i nevojshëm nga (50%+1) i delegatëve që kanë të drejtën e votës.
7. Nëse shumica e thjeshtë (50%+1) nuk arrihet, një mbledhje tjetër e Kuvendit duhet të thirret brenda 24 orëve pas të parës, me të njëjtin rend dite.

NENI 22

DREJTIMI I KUVENDIT

1. Kuvendi drejtohet nga Kryetari ose në mungesë të tij nga një zëvendëskryetar, Kur edhe ai mungon mbledhja drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm.
2. Kuvendi cakton komisionin e numërimit të votave të përbërë nga 3 - 5 persona.
3. Drejtuesi i mbledhjes është përgjegjës për respektimin e rendit të ditës. Ai përcakton edhe kohën në dispozicion të çdo anëtari për diskutim.
4. Proçedura e mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së Kuvendit drejtohet nga ndonjë anëtarë i propozuar dhe i votuar nga pjesëmarrësit.
5. Sekretari i Përgjithshëm është i obliguar që të përgatit raportin mbi ecurinë e Kuvendit (Proces Verbalin) i cili duhet të dërgohet tek anëtarët e Kuvendit të FGJK-së, tek MKRS, KOK, brenda 7 ditëve mbas datës së mbledhjes, i njejti raport duhet të përkthehet në gjuhën angleze dhe të dërgohet në FIG, EG, COMEGYM dhe BG.

KREU IV

NENI 23

ZGJEDHJET

1. Votimi në zgjedhje bëhen me votim të fshehtë.
2. Zgjedhja e kryetarit duhet të bëhet mbi bazën e (50%+1) të votave të delegatëve me të drejtë vote në raundin e parë, dhe nëse është vetëm një kandidat votimi bëhet me ngritje dore (aklamacion), nësë ka më shumë delegatë votohet me votim të fshehtë. Nëse në raundin e parë askush nuk arrinë vota 50%+1, në raundin e dytë votohen për një ose dy kandidatët që kanë fituar vota më së shumti. Në rast se votat janë të njëjta bëhet një raund tjetër. Në rast se përsëri ky votim është i njëjtë, kandidatët duhet të përcaktohen nga shorti, i cili organizohet nga komisioni i numërimit të votave.
3. Zgjedhja e anëtareve bëhet me shumicën e votave të delegatëve me të drejtë vote në mbledhje. Në rast se numri i votave për anëtar në raundin e parë është i barabartë atëherë të njejtit shkojnë në balotazh.
4. Ç'do kandidat duhet të propozohet nga të paktën një anëtar i FGJK, jo më vonë se 5 ditë para datës së asamblesë, në rendin e ditës të së cilës është vendosur zgjedhja e

Bordit Ekzekutiv. Secili kandidat duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme.
5. Votat e hedhura janë votat PËR dhe votat KUNDËR. Abstenimi llogaritet votë kundër në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Votat e pavlefshme nuk llogariten si vota të hedhura.
6. Në rast të votimi të fshehtë, (3) delegat do të emërohen, për miratim nga Kuvendi, për të vepruar në cilësinë e komisionit verifikues.
7. Komisioni verifikues është përgjegjës për organizimin e saktë të votimit dhe fletëvotimit, sigurimin e kutisë votuese transparente dhe të sigurtë, përfshirë shpërndarjen e fletëve të votimit, numërimin e votave të hedhura në prezencë të delegatëve dhe shpalljen e rezultatit të votimit.
8. Për tu zgjedhur në cilëndo pozitë të organeve të FGJK-së, një kandidat duhet të marrë shumicën e thjeshtë të votave PËR nga delegatët e pranishëm me të drejtë vote.

NENI 24

KRYETARI

1. Kandidati për Kryetar duhet:
1.1. të jetë shtetas i Kosovës, me banim në Kosovë.
1.1. të jetë veprimtar i dalluar i sportit të gjimnastikës me rezultate në organizimin dhe udhëheqjen e sportit.
1.2. të ketë përgatitje superiore shkollore.
1.3. të njohë një gjuhë të huaj botërore (përparësi i jepet gjuhës angleze).
1.3. të ketë figurë të pastër morale.
1.4. të ketë moshën mbi 30 vjeç,
1.5. të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë në Kosovë dhe të huaj.
1.6. të mos ketë konflikt interesash me postin e Kryetarit.

NENI 25

DETYRAT E KRYETARIT

1. Detyrat e Kryetarit janë si më poshtë:
   a. Të përfaqësojë FGJK si i vetmi përfaqësues i saj.
   b. Të kërkojë thirrjen e Kuvendit dhe të thërrasë mbledhjet e Bordit Ekzekutiv.
   c. Të drejtojë Kuvendin po ashtu edhe takimet e Bordit Ekzekutiv.
   ç. Të sigurojë zbatimin e vendimeve të Kuvendit dhe të Bordit Ekzekutiv.
   d. Në rast se Kryetari mungon, detyrat mund t'i ngarkohen Zëvendëskryetarit.
   dh. Në rastin kur Kryetari jep dorëheqjen Bordi Ekzekutiv cakton zëvendëskryetarin të kryejë funksionet e Kryetarit përkohësisht, deri në thirrjen urgjente të Kuvendit të Jashtëzakonshëm.
   e. Nënshkruan vendimet e Bordit Ekzekutiv e të Kuvendit,
   ë. Kujdeset për zbatimin e plotë të programeve të punës dhe atyre financiare,

f. Nënshkruan Vendimet dhe konkluzat e Bordit Ekzekutiv dhe të Kuvendit,
g. Ka të drejt vetoje në Vendimet e Bordit Ekzekutiv dhe organeve tjera deri në seancën e parë të Kuvendit,
gj. Merr Vendime në kushte të jashtëzakonshme kur nuk mund të mblidhet Bordi Ekzekutiv apo Kuvendi dhe i njofton këto organe në momentin e parë të mundshëm,
h. Ka të drejt të largojë nga Bordi Ekzekutiv çdo anëtar të tij, nëse nuk është aktiv apo nuk vepron në frymën e akteve normative të FGJK-së dhe synimeve të saj, deri në seancën e parë të Kuvendit,
i. Kryetari për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të FGJK.
j. Kryetari mund të shkakrohet edhe para skadimit të afatit zgjedhor me humbjen e besimit ose me kërkesën e vet.
k. Për shkarkimin e kryetarit, vendoset nëse me vota deklarohen mbi 50%+1 të numrit të delegatëve me të drejtë vote në Kuvend.
ll. Propozon Sekretarin e FGJK-së dhe kryen edhe punë tjera sipas nevojës dhe kërkesave që kërkon momenti dhe Kuvendi apo Bordi Ekzekutiv.

NENI 26

BORDI EKZEKUTIV I FGJK-SË

1. Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, përbëhet nga 9 vetë duke përfshirë Kryetarin, zëvendëskryetarët dhe anëtarët e tjerë. Kryetari dhe 5 anëtar zgjedhen nga Kuvendi 1 anëtarë nga Komisioni i Sportistëve ndërsa 2 anëtar i emron kryetari me kooptim.
1.1. Kandidati për anëtar të Bordit Ekzekutiv duhet:
- Të jetë shtetas i Kosovës, me banim në Kosovë,
- Të ketë arsim të lartë,
- Të ketë figurë të pastër morale,
- Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë në Kosovë dhe të huaj.
- Të mos jetë njëkohësisht anëtar i një federate tjetër (anëtar komisioni, kolegjiumi etj).
- Të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare.
- Të jetë i propozuar nga një anëtar i federatës (klub sportiv apo shoqatë anëtare).
- Të mos ketë konflikt interesash me të qenit anëtar i Bordit Ekzekutiv.
2. Anëtarët që e propozojnë kandidatin nuk duhet të jenë të pezulluar.
3. Një anëtar i FGJK nuk mund të propozojë më shumë se një kandidat për anëtar në Bordin Ekzekutiv.
4. Kryetari i FGJK-së me automatizëm është anëtar dhe kryetar i Bordit Ekzekutiv,
5. Kyretari i Komisionit të Sportistëve i cili zgjedhet nga votimi i sportistëve, me automatizëm është anëtar i Bordit Ekzekutiv.
6. Pesë (5) anëtar të Bordit Ekzekutiv të FGJK-së i zgjedhë Kuvendi.
7. Dy (2) anëtar 2 anëtar i emron kryetari me kooptim.

8. Në përbërjen e plotë të Bordit Ekzekutiv duhet të jenë të rezervuara së paku tri (3) pozita për gjininë femërore.

NENI 27

KOHËZGJATJA E MANDATEVE

1. Mandati i Kryetarit, zëvendëskryetarit, sekretarit të përgjithshëm dhe anëtarëve të tjerë të Bordit Ekzekutiv është 4 vjeçar, respektivisht deri në javen e katërt të tetorit pas olimpiadës verore të rradhës. Ata kanë të drejtë të rikandidojnë dhe rizgjidhen.
2. Me propozim të kryetarit, Bordi Ekzekutiv shkarkon një anëtar të vetin ose plotëson vendin vakant, ndërsa Kuvendi në mbledhjen e parë të rradhës bjen vendimin definitiv nëpërmjet votimit siç parashikohet në statut për zgjedhjet e FGJK.
3. Kundër vendimit të Bordit Ekzekutiv mund të bëhet ankesë në Komisionin e Ankesave në afatin prej tredhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit. Ankesa e paraqitur nuk e pezullon ekzekutimin e Vendimit.
4. Komisioni i Ankesave është i obliguar të zgjidh ankesën në afatin prej tridhjetë (30) ditëve.

KREU V
NENI 28

MBLEDHJET

1. Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, mblidhet të paktën gjashtë (6) herë në vit dhe poashtu kur thirret nga Kryetari ose me kërkesë specifike nga katër (4) anëtar të Bordit Ekzekutiv në afat brenda 7 ditësh.
2. Mbledhja drejtohet nga Kryetari.
3. Kryetari autorizon sekretarin të bën njoftimin për mbledhje 7 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes. 50%+1 e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv i kërkojnë Kryetarit mbledhjen e Bordit Ekzekutiv jashtë rradhe. Kryetari duhet të mbajë mbledhjen brenda 3 (tre) javëve pas marrjes së kërkesës.
4. Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë pjesë në takimet e Bordit Ekzekutiv pa të drejtë vote.
5. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv nuk mbahen në publik. Bordi Ekzekutiv mund të ftojë palë të treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk kanë të drejtë votimi dhe mund të shprehin opinionin e tyre vetëm me miratimin e Kryetarit të FGJK.
6. Për mbledhjet e Bordit Ekzekutiv mbahet procesverbali, i cili firmoset nga Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm dhe nga çdo antar i Bordit Ekzekutiv, pjesëmarrës në mbledhje dhe vendimet duhet të zbardhen brenda pesë (5) ditëve dhe të bëhen publike.
7. Procesverbali i mbledhjes ruhet në arkiv në dy kopje. Për dëmtimin, falsifikimin apo humbjen e procesverbalit, përgjegjësit mbajnë përgjegjësi ligjore.

NENI 29

KOMPETENCAT E BORDIT EKZEKUTIV TË FGJK-SË

1. Bordi Ekzekutiv është organ drejtues dhe ekzekutiv i FGJK-së dhe ka këto kompetenca:
1.1. Të menaxhojë dhe drejtojë punët e FGJK.
1.2. Të planifikoj aktivitetet dhe kalendarin e veprimtarive kombëtare dhe ndërkombëtare.
1.3. Të monitorojë administrimin e FGJK.
1.4. Të përgatisë dhe të mbajë Kuvend të Zakonshëm dhe të Jashtëzakonshëm:
1.5. Të hartojë dhe miratoj projektbuxhetin dhe ta paraqes në Kuvend.
1.6. Të emëroj dhe shkarkojë anëtarët e organeve gjykuese.
1.7. Të emëroj dhe kur e sheh të arsyeshme të shkarkoj anëtarët e Komisioneve të përhershme.
1.8. Të miratoj rregulloret që hartohen dhe përditësohen nga Komisioni për hartimin e rregulloreve:

1. Rregulloren mbi Punën e Bordit të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës,
2. Rregullore e Komisionit Disiplinor të FGJK-së,
3. Rregulloren e Reprezentacionit të FGJK-së, Ekipit Përfaqësues,
4. Rregullore për Regjistrimin e Klubeve, Shoqatave Gjimnastikore, si dhe Transferet e Gjimnastëve/eve,
5. Rregulloren Anti-Doping,
6. Rregulloren për Përzgjedhjen e më të mirëve të FGJK-së,
7. Rregulloren Teknike për garat e FGJK-së,
8. Kodin Etik dhe të Sjelljes së Trainerëve të FGJK-së,
9. Rregulloren Kundër Ngacmimit dhe Abuzimit,
10. Formular per Regjistrim të Gjimnastëve/teve në FGJK dhe Klube.
11. Rregulloren e Komisionit të Ankesave,
12. Dhe rregullore të reja.

1.9. Të përcaktoj, organizoj dhe anuloj aktivitete zyrtare të nivelit kombëtar dhe ndërkombetar.
1.10. Të ushtrojë të drejtën për të propozuar përfaqësues të FGJK për t'u zgjedhur në këto organizata.
1.11. Propozon Statutin dhe aktet tjera Kuvendit,
1.12. Përpilon planin e punës dhe atë financiar të Federatës,
1.13. Harton planin strategjik të FGJK-së për një cikël Olimpik dhe e miraton atë,
1.14. Cakton llogarinë bankare të FGJK-së, dhe autorizon personat me nënshkrim në të,
1.15. Shqyrton të gjitha aplikimet për anëtarësim të ri bazuar në raportin e komisionit për regjistrim dhe bënë rekomandime për pranimin e tyre në Kuvend.
1.16. Ekzekuton vendimet e Kuvendit,
1.17. Përcakton përdorimin e emrit dhe llogos së FGJK-së.

1.18. Përfaqëson FGJK, në të gjitha çështjet juridike përmes zyrtarëve të saj apo palëve të treta.
1.19. Aprovon listën e zyrtarëve të garave dhe rregulloret e brendshme të Federatës,
1.20. Vendos për blerjen ose shitjen e pasurisë së Federatës,
1.21. Emëron dhe shkarkon Sekretarin e përgjithshëm, në bazë të propozimit të kryetarit,
1.22. Aprovon planprogramin e punës së Këshillit profesional,
1.23. Emëron dhe shkarkon trajnerët e reprezentacioneve,
1.24. Aprovon raportet e Këshillave dhe Komisioneve të Bordit Ekzekutiv,
1.25. Miraton sitemin e garave, kalendarin dhe propozicionet e garave,
1.26. Bartë të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e Federatës,
1.27. Cakton lartësinë e anëtarësisë dhe kotizimeve për anëtarët e Federatës,
1.28. Cakton lartësinë e taksës për zyrtarë të garave,
1.29.Vendosë për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve në Federatë dhe për lartësinë e pagave të tyre,
1.30. Emëron dhe shkarkon Këshillat dhe Komisionet e Bordit Ekzekutiv,
1.31. Vendos edhe për çështjet tjera të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit.

NENI 30

VENDIMMARRJA

1. Bordi Ekzekutiv fillon mbledhjet vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtareve të tij.
2. Bordi Ekzekutiv merr vendime me 50%+1 të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta, Kryetari ka votë vendimtare kur votimi është i hapur.
3. Në rast se një anëtar i Bordit Ekzekutiv ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet ai përjashtohet nga debati dhe votimi për këtë çështje.
4. Vendimet e marra regjistrohen në procesverbal.
5. Vendimet e marra nga Bordi Ekzekutiv hyjnë në fuqi menjëherë, përveç rasteve kur Bordi Ekzekutiv vendos ndryshe.
6. Bordi Ekzekutiv mund të formojë komisione të përhershme dhe të përkohshme, vendos për kompetenca të tyre dhe emëron anëtarët e tyre. Komisionet dhe këshillat për punën e tyre i përgjigjen Bordi Ekzekutiv.
7. Komisionet dhe Këshillat e përhershme janë:
7.1.Këshilli profesional,
7.2.Komisioni për Regjistrimin e Klubeve të reja dhe Kalimin dhe Regjistrimin/Transferimin e Gjimnastëve,
7.3.Komisioni i Garave,
7.4.Komisioni Disiplinor,
7.5. Komisioni për shpalljen e Laureatëve të FGJK-së, etj.

KREU VI

STRUKTURA ADMINISTRATIVE

NENI 31

STAFI MENAXHUES ADMINISTRATIV

1. Bordi Ekzekutiv emëron stafin menaxhues administrativ sipas kritereve të përcaktuara nga Bordi Ekzekutiv dhe themelimi i marrëdhënies së punës bëhet në pajtim me Ligjin e Punës.
2. Sekretari i Përgjithshëm është organi administrativ i FGJK.
3. Sekretarin e përgjithshëm, në bazë të propozimit të kryetarit e emëron Bordi Ekzekutiv me vendim pune pa afat të kufizuar.
4. Kandidati për sekretar të përgjithshëm duhet:
   4.1. Të jetë shtetas i Kosovës me banim në Kosovë.
   4.2. Të ketë arsim të lartë dhe të jetë njohës i sportit të gjimnastikës.
   4.3. Të ketë figurë të pastër morale,
   4.4. Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë në Kosovë dhe të huaj.
   4.5. Të mos jetë njëkohësisht anëtar i një federate tjetër.
   4.6. Të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare.
   4.7. Të mos ketë konflikt interesash me të qenit Sekretar i Përgjithshëm.
   4.8. Të njeh gjuhën Angleze.
5. Përgjegjësit e Sekretari të Përgjithshëm janë sigurimi i ligjshmërisë së punës dhe kryerja e obligimeve të përcaktuara ligjore, administrative, financiare dhe organizative të FGJK-së në mënyrë profesionale dhe sipas parimeve të kodit etik, duke përfshirë por duke mos u limituar edhe në funksionet në vijim:
5.1. Të zbatojë vendimet e Kuvendit, Bordit Ekzekutiv dhe të Komisioneve të Federatës,
5.2. Të bëjë përgatitjet për Kuvend dhe për mbledhjet e organeve të tjera dhe komisioneve.
5.3. Përgatit material, dokumentet dhe raportet e duhura për aplikim në procesin e kategorizimit.
5.4. Të programojë rendin e ditës së Kuvendit dhe të takimeve të Bordit Ekzekutiv.
5.5. Të mbajë korrespondencën e FGJK.
5.6. Të mbajë librat e llogarisë së FGJK.
5.7. Udhëheq me punën e zyrës së Federatës,
5.8. Merr pjesë rregullisht në Kuvend, takimet e Bordit Ekzekutiv dhe në atë të komiteteve këshilluese në një rol këshillues ose anëtarit. Nëse ai nuk është në gjëndje të marrë pjesë, duhet të caktojë një zëdhënës.
6. Sekretari i përgjithshëm në fushveprimtarinë e vetë i kryen këto punë:

6.1.Realizon bashkëpunimin me FIG dhe, me Federatat dhe organizatat tjera sportive jashtë Kosovës,
6.2. Realizon bashkëpunimin me KOK-un, Departamentin e Sporteve në MKRS dhe organizatat tjera sportive në Kosovë,
6.3. Mban kontakte me mjetet e informimit,
6.4.Propozon Bordit Ekzekutiv, profilin e bashkëpuntorëve profesional administrativë.
6.5. Mbikqyrjen e ligës, dhe garave ndërkomëtare dhe përpilimi i rezultateve dhe ranglistave zyrtare.
6.6. Sekretari i përgjithshëm themelon mardhënje të punës me Federatën në bazë të Ligjit mbi marëdhënje të punës.
6.7. Ekzekutimin dhe monitorimin e planit financiar të FGJK-së në bazë të kërkesave dhe vendimeve të Bordit Ekzekutiv.
6.8. Kryen detyrat e menaxhimit financiar, mban arkën, ditarin e hyrje-daljeve, pagesat, etj.
6.8. Zbatimin e plan-programit dhe planit strategjik të FGJK-së.
6.9. Kryen edhe punë tjera të cilat dalin nga aktet tjera normative të FGJK-së.
6.10. Sekretari i përgjithshëm mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit të tij, në qoftëse nuk i kryen obligimet të cilat dalin nga aktet normative.

NENI 32

ADMINISTRATA

1. Korrespondenca, komunikimi, dokumentacioni dhe procedurat e FGJK-së do të zhvillohen në gjuhën shqipe. Sipas kërkesës paraprake të miratuar nga organet e FGJK-së, administrata duhet të kujdeset të sigurojë përkthimin simultan të takimeve të Kuvendit në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.
2. Duke qenë se FGJK është anëtare e plotë e FIG, EG, COMEGYM, dhe BG obligohet administrata që Statuti i FGJK-së të përkthehet në gjuhën angleze dhe të përditësohet pas çdo ndryshimi dhe plotësimi të tij.

NENI 33

SHËRBIMI ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL

Federata mund të themeloj mardhënje të punës me punëtorët të cilët do të punojnë në shërbimin profesional dhe administrative të Federatës. Për punësimin e punëtorëve dhe për lartësinë e pagave vendos Bordi Ekzekutiv me propozim të Sekretarit të përgjithshëm, duke lidhur kontratë për detyra specifike.

KREU VII

NENI 34

KËSHILLAT DHE KOMISIONET

FGJK ka këshillat dhe komisionet e veta, dhe të gjitha vendimet në Këshillat dhe Komisionet e Federatës mirren me shumicën e votave.
Vendimet e Këshillave dhe Komisioneve janë të plotfuqishme në qoftëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.
Anëtari i Këshillit apo Komisionit të FGJK-ës i cili nuk është prezent në mbledhje mund të deklarohet edhe me shkrim, nëpërmjet postës elektronike apo telefaxit.

NENI 35

KËSHILLI MBIKQYRËS

1. Këshilli mbikqyrës përbëhet prej tre (3) anëtarëve, dhe mbikqyrë veprimtarinë e FGJK-së.
2. Këshillin mbikqyrës e zgjedhë Kuvendi me mandat katër vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjës edhe për një mandat të njëpasnjëshëm.
3. Anëtari i këshillit mbikqyrës nuk mund të jetë anëtar i organeve dhe trupave të Federatës.
4. Bordi Ekzekutiv dhe të gjitha trupat e tij janë të obliguara që Këshillit mbikqyrës ti mundësojnë mbikqyrjën në punën e tyre.
5. Këshilli mbikqyrës përcjell ligjshmërinë e punës së Bordit Ekzekutiv, organeve dhe trupave në mes të dy Kuvendeve dhe mbikqyrë afarizmin financiar të Federatës.
6. Këshilli mbikqyrës i raporton për punën e vetë Kuvendit të FGJK.
7. Shkarkimi i anëtarit të Këshillit Mbikqyrës e bën Kuvendi në procedurë të njëjtë sukurse zgjedhen e tyre.
8. Mënyra e punës së Këshillit mbikqyrës më përafërsisht përcaktohet me Rregullorën mbi punën e Këshillit mbikqyrës.

NENI 36

KËSHILLI PROFESIONAL

Këshilli profesional është organ profesional i Federatës, i cili kujdeset për zhvillimin profesional të Gjimnastikës. Këshilli profesional numëron tre anëtarë, të cilët i emëron Bordi Ekzekutiv me mandat katër vjeqar, me të drejtën e rizgjedhjës edhe për një mandat. Për punën e vetë i përgjigjet Bordi Ekzekutiv.
Të drejtat dhe obligimet e Këshillit profesional janë:

-Të përcjellë zhvillimin e gjimnastikës sportive mbrenda dhe jashtë,
-Të mbikqyrë realizimin e planprogrameve të aprovuara nga Bordi Ekzekutiv,
-Kujdeset për zhvillimin profesional dhe popullarizimin e gjimnastikës sportive,
-Bashkëpunon me organizatat profesionale dhe shkencore me qëllim të përparimit të punës profesionale,
-Propozon Bordit Ekzekutiv emërimin dhe shkarkimin e trajnerëve të Reprezentacioneve,
-Kujdesët për përparimin profesional të trajnerëve,
-Propozon Bordit Ekzekutiv aprovimin e planprogrameve për zhvillimin e gjimnastikës,
-Propozon sistemet e garave për të gjitha grupmoshat,
-Kryen edhe punë tjera me të cilat i ngarkon Bordi Ekzekutiv.

NENI 37

KOMISIONI PËR REGJISTRIM

Komisioni për regjistrim numëron tre anëtarë, të cilët i emëron Bordi Ekzekutiv me mandat po aq sa të Bordit Ekzekutiv të FGJK-së, me të drejtën e rizgjedhjës edhe për një mandatë.
Komisioni për kalimin dhe regjistrimin e gjimnastëve regjistron gjimnastët gjatë afateve kalimtare dhe vendos për çështjet statusore të gjimnastëve.
Komisioni merr vendime me shkrim për regjistrimin ose mosregjistrimin e gjimnastëve gjatë afateve kalimtare.
Komisioni i merr vendimet në bazë të Rregullorës për kalimin dhe regjistrimin e gjimnastëve dhe Ligjeve në fuqi.

NENI 38

KOMISIONI I GARAVE

Komisioni i garave në fushveprimtarinë e vetë i kryen këto punë:
-Propozonë propozicionet e garave,
-Propozonë kalendarin e garave,
-Regjistronë objektet në të cilat do të zhvillohen ndeshjet kampionale,
-Në përputhje me Propozicionet e garave, regjistron prezentimet dhe turnet kampionale dhe vendos në shkallë të parë në lidhje me ankesat në prezentime,
-Propozon lartësinë e taksave për zyrtarë të ndeshjeve,
-Zbaton sanksionet e parapara në propozicione të garave,

KREU VIII

E DREJTA NE MJETET JURIDIKE

NENI 39

ORGANET VENDIMMARRËSE

1. Organet e mëposhtme të FGJK-së kanë kompetenca vendimmarrëse:
1.1. Kuvendi;
1.2. Bordi Ekzekutiv;
1.3. Komisioni Disiplinor;
1.4. Komisioni i Ankesave;

NENI 40

Rregullat procedurale të zbatueshme për organet vendimmarrëse,
1. Organet vendimmarrëse të FGJK-së sigurojnë procedura të drejta për të gjitha palët e përfshira dhe do të respektojnë të drejtat e tyre themelore. Ata njohin në mënyrë të veçantë:
1.1. Që çdo person që vepron në FGJK nuk do të marrë pjesë në ndonjë bashkëveprim i cili mund të ndikojë në një përfundim ose vendim në lidhje me ndonjë çështje specifike nëse personi ka një konflikt interesi sipas Kodit të Etikës;
1.2. E drejta e Anëtarit të FGJK-së të ketë qasje në dokumentacionin e FGJK-së dhe të ekzaminojë dosjen përkatëse;
1.3. E drejta për t'u njoftuar me sanksionet apo gjobat që mund të shqiptohen;
1.4. E drejta për t'u dëgjuar, për të paraqitur një mbrojtje, për të dëshmuar dhe për t'u ndihmuar nga mbrojtësit me shpenzimet e tyre;
1.5. E drejta për të paraqitur ankesë në komisionin e ankesave.

NENI 41

KOMISIONI DISCIPLINOR

1. Komisioni disiplinor përbëhet prej tre (3) anëtarëve, të cilët i emëron Bordi Ekzekutiv me mandat sa të Bordit Ekzekutiv të FGJK, me të drejtën e rizgjedhjës edhe për një mandat. Komisioni disciplinorë vendosë në shkallë të parë në lidhje me shkeljet e Rregullorës disciplinore, me të cilën më përafërsisht rregullohen të drejtat dhe obligimet e Komisionit, si dhe procedura e vendimmarrjës në lidhje me shkeljet disiplinore.
2. Anëtarët e FGJK-së përfshirë anëtarësinë e tyre përgjigjen para Komisionit Disiplinor nëse bien në kundërshtim me detyrat e përcaktuara me aktet normative të FGJK-së.

3. Kërkesën për nismën e procedurës disiplinore mund ta bëjë çdo anëtar i Kuvendit që përfaqëson një klub sportiv të gjimnastikës, anëtarët e Bordit Ekzekutiv, anëtarët e ekipeve përfaqësuese, anëtarët e administratës, komiteteve apo komisioneve.
4. Komisioni Disiplinor vepron duke u bazuar në Kodin Disiplinor të FGJK-së.
5. Kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor mund të bëhet ankesa në Komisionin e Ankesave në afatin prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit. Ankesa e paraqitur nuk e pezullon ekzekutimin e Vendimit.
6. Komisioni i Ankesave është i obliguar të zgjidh ankesën në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit.
7. Nëse anëtari, të cilit i është ndërprerë mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, ka qenë anëtar i Komisionit Disiplinor, propozohet një anëtar i ri nga ana e Kryetarit të FGJK-së, dhe zgjedhet nga Bordi Ekzekutiv me 50%+1, të anëtarëve prezent.

NENI 42

KOMISIONI I ANKESAVE

1. Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre (3) anëtarë të zgjedhur nga Bordi Ekzekutiv. Anëtarët referohet të kenë një arsimim juridik ose përvojë në çështjet juridike.
2. Vendimet e Komisionit të Ankesave janë përfundimtare për çdo ankesë që paraqitet ndaj organeve vendimmarrëse të FGJK-së.
3. Një anëtar i Komisionit të Ankesave nuk mund të mbajë e as të marrë një pozicion në organet e tjera juridike të FGJK-së.
4. Komisioni i Ankesave vepron duke u bazuar në Rregulloren përkatëse të Komisionit të Ankesave.
5. Nëse anëtarit, të cilit i është ndërprerë mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, ka qenë anëtar i Komisionit të Ankesave propozohet një anëtar i ri nga ana e Kryetarit të FGJK-së dhe zgjedhet nga Bordi Ekzekutiv me 50%+1, të anëtarëve prezent.

NENI 43

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE PËR SPORT DHE ANTI-DOPING

1. Në rast se ndonjë klub ose sportist konsideron se të drejtat e tij janë shkelur nga FGJK edhe pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve juridike brenda FGJK-së, i njejti ka të drejtë të ushtrojë ankesë në MKRS në përputhje me Nenin 50 të Ligjit përkatës për Sport.
2. Pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë ti drejtohet Komisionit të Arbitrazhës Sportive të Komitetit Olimpik të Kosovës me seli në Prishtinë (Kosovë).

3. Agjencioni i Kosovës për Anti-doping njihet nga FGJK si organi përfundimtar për të gjitha çështjet e hapura apo të ngritura mbi Anti-dopingun që mund të ndërlidhen me FGJK ose anëtarët e saj dhe palët e përfshira duhet të marrin përsipër të zbatojnë Statutin dhe rregullat procedurale të kësaj Agjencie dhe ti pranojnë dhe zbatojnë vendimet e saja, të cilat janë përfundimtare.

NENI 44

POZITAT VAKANTE

1. Nëse Kryetari i FGJK-së jep dorëheqje ose nuk është në gjendje të vazhdojë më gjatë në detyrë, ai ose ajo do të zëvendësohet nga nënkryetari i parë, i cili obligohet të organizojë zgjedhjet e jashtëzakonshme zgejdhore brenda afatit prej 30 ditësh.
2. Mandati i Kryetarit të zgjedhur pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme do të jetë për aq kohë sa ka mbetur mandat nga Kryetari paraprak për të siguruar se zgjedhjet mbahen mbi bazën e ciklit olimpik.
3. Kryetari ka të drejtë të nominoj një anëtar të ri të çdo organi të FGJK-së të zgjedhur nga Kuvendi nëse në organin e njëjtë mbetet një pozitë e lirë vakante. Anëtari i ri i propozuar nga Kryetari do të ushtrojë detyrat e tij/saj deri në Kuvendin e radhës.
4. Mandati i anëtarëve të bordit është i lidhur me mandatin e Kryetarit.
5. Në rastin e kalimit të sukseshëm të mocionit të mosbesimit të organeve ekzekutive të FGJK-së, anëtarët e Kuvendit caktojnë një komision përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme brenda afatit prej 30 ditësh.

NENI 45

E DREJTA PËR KANDIDIM

1. Nominimet e kandidimet për pozitat për: Kryetar, anëtarë të Bordit Ekzekutiv, Komisionit të Ankesave, Këshillit Mbikqyrës, Komisionit të Garave, Komisionit Disiplinor, etj, mund të bëhen vetëm nga anëtarët e regjistruar në FGJK.
2. Një anëtar mund të nominoj nga një kandidat për një organ të FGJK-së.
3. Një Anëtar që nuk ka të drejtë vote nuk e ka as të drejtën e nominimit.
4. Një person i lidhur në çfarëdo mënyre me prodhimin apo shitjen e pajisjeve gjimnastikore, në momentin e zgjedhjes në Bordin Ekzekutiv duhet të jap dorëheqje nga pozitat tjera që kanë të bëjnë me prodhimin apo shitjen e pajisjeve e të cilat përbëjnë konflikt interesi.
5. Një Anëtar që është dënuar ndonjëherë me aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, nuk ka të drejtë të kandidohet për asnjë pozitë në kuadër të organeve të FGJK-së.

NENI 46

KONFLIKT INTERESI

1. Anëtarët e një organi të FGJK-së duhet të shmangin çdo situatë që mund të çojë në një konflikt interesi ose konflikt të përceptuar të interesit. Çdo konflikt aktual, i përceptuar ose i mundshëm i interesit duhet të deklarohet dhe individi duhet të ndërmarrë veprime për të hequr veten nga situata ku mund të lindë një konflikt. Është përgjegjësi personale e secilit person të shmangë çdo rast të konfliktit të interesit.

NENI 47

SJELLJA E DUHUR

1. Të gjithë anëtarët e organeve vendimmarrëse të FGJK-së do t'i kryejnë detyrat në mënyrë të duhur dhe të pavarur, për interesat më të mira të gjimnastikës në Kosovë, pa marrë parasysh interesat e veçanta.
2. FGJK-ja ka Rregulloren përkatëse për kodin etikës.

KREU IX

FINANCA

NENI 48

PERIUDHA FINANCIARE

1. Viti financiar kalendarik i FGJK-së është nga 1 janari deri më 31 dhjetor. Llogaritë dhe raportet financiare mbahen në Euro dhe menaxhohen në përputhje me kërkesat e standardeve të kontabilitetit të pranueshëm dhe të zbatueshëm në Kosovë dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike të Kosovës.
2. Sekretari i Përgjithshëm obligohet që të përgatit raportin vjetor financiar, i cili kontrollohet nga Këshilli Mbikqyrës pas miratimit nga Bordi Ekzekutiv dhe i njejti i paraqitet Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim.
3. Raporti vjetor financiar, pas aprovimit nga Kuvendi duhet të auditohet nga një auditor i jashtëm i pavarur dhe të përfundohet deri më 31 mars të vitit pasues.
4. Llogaria bankare e FGJK-së mbahet në bankën komerciale të aprovuar nga Bordi Ekzekutiv.

NENI 49

KONTROLLI I BRENDSHËM

1. Këshilli Mbikqyrës i ka të gjitha kompetencat për vlerësimin dhe monitorimin e brendshëm të FGJK-së për të siguruar ligjshmërinë e veprimtarisë të punës dhe zbatimin e akteve normative të FGJK-së.
2. Këshilli i paraqet Kuvendit një raport vjetor të aktiviteteve dhe rekomandimeve të tij.

NENI 50

KUOTIZIMI

1. Çdo Anëtar është i obliguar të kryejë me sukses pagesën vjetore për anëtarësim në FGJK siç përcaktohet nga Bordi Ekzekutiv.
2. Një Anëtarë i cili është dorëhequr apo pezulluar nga Kuvendi dhe i cili ka borgje financiare apo asete në shfrytëzim ndaj FGJK-së, është i obliguar t'i kthejë ato më së largu 30 ditë nga momenti kur i është ndëprerë anëtarësimi në FGJK.

NENI 51

BURIMET FINANCIARE

Të ardhurat e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës sigurohen nga:

a. Granti i përcaktuar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.
b. Regjistrimet vjetore të anëtarëve.
c. Të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon Federata.
d. Nga sponzorimet, donacionet, dhurimet, financimet nga shteti dhe burime të tjera të lejuara.
e. Nga liçencimi i trajnerëve, sportistëve, gjyqtarëve, mjekëve, vëzhguesve, specialistëve, amatorëve.
f. Të hyrave nga organizimi i garave dhe
g. Burimet tjera të lejuara në bazë të Ligjit.

Me afarizmin financiar të Federatës udhëheq Kryetari në bazë të planit financiar dhe vendimeve të Kuvendit dhe Bordit Ekzekutiv.
Për ndihmë në realizimin e afarizmit të Federatës, mund të punësohet referenti financiar në përputhje me Ligjin mbi mardhënjen e punës.

DISPOZITAT KONTRAKTUALE DHE FINANCIARE

NENI 52

KONTRATAT

1. Bordi Ekzekutiv vendos varësisht nga rëndësia dhe vlera financiare e kontratës për autoritetin që do të bëjë nënshkrimin.

2. Për ekzekutimin e pagesave mbi vlerën 500 euro, kërkohet edhe autorizimi i Kryetarit ose Nënkryetarëve të Bordit sipas radhës në mungesë të kryetarit.

NENI 53

GARAT

Garat zyrtare në Kosovë mund të organizohen vetëm nga Federata, ose organi i autorizuar nga Bordi Ekzekutiv.
Garat zhvillohen në bazë të rregullave të FIG, – dhe rregulloreve të FGJK.
Në udhëheqjën e garave organi përkatës i garave duhet ti respektoj të gjitha vendimet e FIG, dhe rregulloreve të FGJK.
Fillimin, shtyerjën, propozicionet e garave kampionale dhe turneve i miraton Bordi Ekzekutiv e FGJK.

NENI 54

PËRFAQËSUESJA E KOSOVËS

1. Me qëllim të përparimit dhe realizimit të arritjeve të rezultateve të larta në Sportin e Gjimnastikës, si në arenën vendore apo ndërkombëtare, FGJK-ja formon ekipet e përfaqësueses së Kosovës në gjimnastikë artistike për femra, gjimnastikë artistike për meshkuj, gjimnastikë ritmike, (në tekstin e mëtejmë: Përfaqësuesja) për të gjitha grupmoshat.
2. Udhëheqja e ekipit të Përfaqësueses së Kosovës është në kompetencë të Kryetrajnerit/Përfaqësuesit të Përfaqësueses së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Drejtori).
3. Në punën profesionale me ekipet e Përfaqësueses angazhohen edhe trajnerët e përfaqësuesve që nominohen nga Drejtori dhe aprovohen nga Bordi Ekzekutiv.
4. Me rregulloren e punës së ekipit të Përfaqësueses së Kosovës përcaktohet mënyra e veprimtarisë, të drejtat dhe obligimet, kushtet e punës së Drejtorit, dhe anëtarëve tjerë të ekipit të Përfaqësueses.

NENI 55

PËRZGJEDHËSI I PËRFAQËSUESES SË KOSOVËS

1. FGJK-ja e ka Përfaqësuesën e Kosovës të cilin e zgjedh Bordi Ekzekutiv sipas konkursit të brendshëm ose të jashtëm publik .
2. Përfaqësuesi është i pavarur në punën e tij profesionale, ndërsa për punën dhe përgjegjësitë e tij/saj i përgjigjet Bordit Ekzekutiv.
3. Përfaqësuesi bën përzgjedhjen dhe përbërjen e sportistëve të Përfaqësueses për të gjitha grupmoshat, duke u bazuar në kriteret meritore dhe profesionale të pasqyruara në Planin Profesional të Punës të Përfaqësuesi të miratuar nga Bordi Ekzekutiv, për të siguruar një paraqitje sa më të suksesshme, etike, profesionale dhe dinjitoze të Përfaqësueses së Kosovës në ngjarjet dhe garat ndërkombëtare.

4. Përfaqësuesi, krahas planit profesional të punës, obligohet të dorëzojë raportin pas secilit përfaqësim ndërkombëtarë si dhe raportin vjetor të punës të cilat duhet të miratohen nga Bordi Ekzekutiv.
6. Një person për të kandiduar dhe për t'u emëruar Përfaqësues i Kosovës duhet të plotësoj kushtet dhe kriteret minimale si në vijim:
6.1. Të jetë veprimtar i dalluar i sportit të gjimnastikës me rezultate kulminante në organizimin dhe udhëheqjen e sportit;
6.2. Të ketë përgatitje superiore shkollore, preferohet fakulteti i edukatës fizike ose i certifikuar në njërin nga nivelet formale të FIG, EG, për trajner;
6.3. Të njeh një gjuhë zrtare të FIG, përparësi i jepet gjuhës angleze;
6.4. Mos të ketë rënë në kundërshtim me normat etike dhe morale dhe me parimet e Lëvizjes dhe Kartes Olimpike dhe të mos jetë i denuar me aktgjykim të formës së prerë për cfarëdo vepre penale.
7. Përfaqësuesi zgjidhet për një mandat katër (4) vjeçar me mundësi të ri-kandidimit dhe përzgjedhjes së sërishme.

KREU X

NENI 56

TRASPARENCA DHE PUNA PUBLIKE

1. Veprimtaria dhe puna e FGJK-së është transparente dhe publike.
2. Komisioni pwr hartimin e rregulloreve me aprovim tw Bordit Ekzekutiv, harton dhe përpilon rregulloren për klasifikimin e informacioneve dhe obligohet Sekretari i Përgjithshëm të ofrojë transparencën, publikimin dhe qasjen e tyre sipas kësaj rregullore.
3. Komisioni pwr hartimin e rregulloreve me aprovim tw Bordit Ekzekutiv, harton dhe përpilon rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale bazuar në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe obligohet Sekretari i Përgjithshëm të aplikojë këtë rregullore.
4. Veprimtaria dhe puna publike e FGJK-së duke mos u limituar bëhet edhe përmes hapave në vijim:
4.1. Nëpërmjet dërgimit elektronik dhe me kohë të materialeve për shqyrtim, anëtarëve të organeve të FGJK-së dhe personave tjerë të ftuar apo të interesuar;
4.2. Nëpërmjet njoftimit përmes mjeteve të informimit, portaleve sociale, faqes së internetit të FGJK-së dhe mjeteve tjera komunikuese për organizimin dhe mbajtjen e takimeve, seminareve, aktiviteteve apo ngjarjeve tjera;
4.3. Informimit të komunitetit sportiv dhe qytetarëve për punën dhe afarizmin e FGJK-së;
4.4. Publikimin e dokumenteve dhe informacioneve të ndryshme në faqen zyrtare të internetit të FGJK-së http://www.fgjk-kos.com/në përputhje me aktet normative të FGJK-së;

4.5. Nëpërmjet konferencave për shtyp dhe forma tjera të komunikimit;
4.6. Dhe çdo forme tjetër të komunikimit apo publikimit që mund të bazohet në rekomandimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

KREU XI

NENI 57

MIRËNJOHJET, SHPËRBLIMET DHE LAUREATËT

Mirënjohjet dhe shpërblimet
1. FGJK-ja ndan mirënjohje dhe shpërblime në shenjë të mirënjohjes për kontribut të veçantë ndaj një individi apo organizate në promovimin dhe zhvillimin e sportit të Gjimnastikës.
2. Me rregulloren përkatëse për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve përcaktohen procedurat, kushtet, mënyra e propozimit dhe e miratimit të kandidatëve.

NENI 58

LAURETATËT

1. FGJK-ja në baza vjetore shpall Laureatët e Vitit.
2. Bordi Ekzekutiv përcakton në bazë të mundësive buxhetore nivelin apo llojin e shpërblimit për tu ndarë Laureatëve të Vitit në FGJK.
3. Me rregulloren përkatëse për zgjedhjen e më të mirëve përcaktohen procedurat, kushtet, dhe kriteret për përzgjedhjen e Lauretatëve të FGJK-së.

KREU XII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

NENI 59

SHPËRBËRJA

1. Për shpërbërjen e FGJK-së, nevojitet prezenca në Kuvend e më shumë se dy të tretave (2/3) e delegatëve me të drejte vote dhe kërkohet shumica e katër të pestave (4/5) të votave të hedhura PËR ose nëse numri i anëtarëve është më i vogël se pesë (5) të cilët veprojnë në së paku tri (3) qytete të ndryshme të Kosovës.
2. Në rast të shpërbërjes së FGJK-së, Kuvendi do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit në Kosovë që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jenë paguar borxhet e organizatës. Shoqata/t ose fondacioni/et e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njejta ose të ngjajshme sikurse organizata.

NENI 60

RREGULLORET E BRENDSHME

Rregulloret e brendshme dhe propozicionet e garave nuk guxojnë të pësojnë ndryshime, gjatë edicionit garues i cili është në rrjedhën e sipër.
Në procedurat administrative të cilat zhvillohen pranë organeve kompetente të Federatës mund të përdoren mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.
Për çështjet administrative të cilat nuk janë të rregulluara me këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e Kodit mbi procedurat administrative. (Deri në miratimin e Kodit të sipërpërmendur do të aplikohen dispozitat e Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative).

NENI 61

Shtetësia e gjimnastëve dhe pjesmarrja në Lojrat Olimpike janë të rregulluara me Statutin e FIG. Çdo rast i papritur apo ndonjë rast që nuk parashikohet , do të zgjidhet nga Bordi Ekzekutiv në përputhje me Statutin e FIG, ku është e aplikueshme e cila mund të jetë në lidhje me Kodin e Disiplinës , të Kodit të Etikës , apo ndonjë Masë disiplinore.

NENI 62

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit bëhen në formë dhe sipas procedurave të parapara për aprovimin e tij.
2. Të gjitha aktet normative të FGJK-së do të harmonizohen me këtë statut.
3. Interpretimin e këtij Statuti e bënë Kuvendi i Federatës.

NENI 63

HURJA NË FUQI

Ky Statut hynë në fuqi ditën që aprovuar, nga Kuvendi i Federatës, me 18 Prill 2026,

Kryetari i FGJK-së:

Shkumbin Maqastena

Sekretari i FGJK-së:

Amir Tahiraga

Prishtinë 18 Prill 2026